Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/307
Datë: 13.05.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6, nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenit 99 dhe 135 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), përmes votimit në mënyrë elektronike me datë 10.05.2024 mori këtë:

## V E N D I M

I. Shtyhet afati fillestar për shqyrtim dhe vendosje për ankesën e Institucionit "Sellma Academy" Nr. 01/221 e datës 19.04.2024, kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/151, i datës 15.03.2023.

II. Vendimi që zgjidh ankesën do të merret jo më larg se afati fillestar prej tridhjetë (30) ditësh shtesë.

## A r s y e t i m

Institucioni "Sellma Academy" brenda afatit ligjor me datë 19.04.2024 ka parashtruar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve ankesë me Nr. 01/221, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr. 01/151 të datës 15.03.2024.
Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) për shkak të kompleksitetit të kësaj çeshtje administrative ka konstatuar se i nevojitet afat kohor shtesë për shqyrtim të ankesës. Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së me qëllim të shqyrtimit dhe analizimit profesional të ankesës së bashku me të gjitha shkresat dhe provat e bashkangjitura në ankesë, me shumicë votash të anëtarëve përmes votimit elektronik ka vendosur të shtyhet afati fillestar për shqyrtimin dhe vendosjen mbi ankesën e institucionit "Sellma Academy" me qëllim të nxjerrjes së një vendimi meritor dhe të drejt.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) duke u bazuar në kompetencat ligjore në kuptim të nenit 99 dhe nenit 135 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim nuk është akt administrativ përfundimtar në kuptim të nenit 97 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj, nuk lejohet ankesë.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "Sellma Academy"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së